

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Futi paisjet e 'Botox' kontrabandë, 285 mln lekë të pa paguara! Merret i pandehur biznesmeni Dritan Gre mi
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/futi-paisje-e-botox-kontrabande-285-mln-leke-te-pa-paguar-a-merret-i-p-i104494
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 16:17:40 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 16:14:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ebd6264c3a5d8c430cc232c9bcfe02a65d88038dcbcbfe76b49a31b0a1a63732
TEKSTI	5aacc3782c793fefcad8fd1fb6e1eed59997316da3ae7b8791adf3d7348efe77
PAMJA	99208dca703b3a44d3527e418b65c6d33738ed9ffb02dca297fb3dcd203898f6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4c348620b2474f8099e03e14aaf287e8658b3b947a205e1a1501454e7ce0993a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	6d78d2dc60f31cde5fa6ff278c9155b75ea76fff53014b2b93764708aa00c94f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4c348620b2474f8099e03e14aaf287e8658b3b947a205e1a1501454e7ce0993a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- EDITORIAL
- EMISIONE
- INVESTIGIME
- AKTUALITET
- SOCIALE
- POLITIKË
- KOSOVA
- BOTA
- SHOWBIZ
- LIFESTYLE
- SPORT

SYRI LIVE



Flash:

pas dënimit të për misione të posaçme, Richard Grenell, reagoi

norvegjezit

vazhdojnë të qarkullojnë, ndërsa protestat

edhe Olta Xhaçkën: O

Ballën, protestuesit këtë herë

që dënoi me 81 vit

gjykues në çështjen

Hagës: Një ditë

ndaj katër drejtuesve të UÇK-së,

AKTUALITET

Futi paisjet e 'Botox' kontrabandë, 285 mln lekë të pa paguara! Merret i pandehur biznesmeni Dritan Gremi

Piranjat Përditësimi i fundit 16 Shtator 2026, 18:14



Një dosje hetimore që bën fjalë për “kontrabandim të medikamenteve mjekësore” dhe “Fshehjen e të ardhurave financiare” është rregjistruar në gjykatën e Tiranës, me të pandehur Dritan Gremi dhe shoqërinë Juridike, “Gremi Wellnes”. Çështja penale me emrin e biznesmenit të disa klinikave estetike dhe 11 bizneseve të hapura në Tiranë dhe Elbasan, është publikuar si i pandehur në seancat gjyqësore që gjykata e Tiranës, ka planifikuar të gjykojë në 22 shtator 2026.

Vetëm dy vite më parë Emisioni Piranjat investigoi rastin e kontrabandimit.

Kujtojmë se në muajin Tetor 2025, Dritan Gremi, u shfaq dhe si kandidat i pavarur për të garuar në zgjedhjet për kryetar bashkie në Tiranë, zgjedhje këto që nuk u zhvilluan kurë. Siç mëson gazetari Elton Qyno, dosja me 2 të pandehur është ende në fazën e shqyrtimit gjyqësor në seancën paraprake dhe gjyqtare e çështjes është caktuar përmes shortit elektronik, Amarilda Sulaj.

Sipas dosjes hetimore, të pandehurit Dritan Gremi dhe shoqëria e tij “Gremi Wellnes” dyshohet se kanë kryer kontrabandë të medikamente mjekësorë, kryesisht “Botox” me princip aktiv “Botulinum toxin”. Ky medikament mjekësor aktualisht nuk është i paisur me autorizim për tregtim në Shqipëri.

Ndërkohë edhe paisjet mjekësore që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë, duhet të regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Paisjeve Mjekësore, procedurë kjo që mbahet nga Agjensia Kombëtare e Barnave dhe Paisjeve Mjekësore.

Në klinikë janë gjetur paisje mjekësore të paçertifikuara dhe kryheshin injeksione nga persona të cilët nuk janë mjekë por estetiste. Fakt ky i konfirmuar nga disa pacientë që janë pyetur.

Shkeljet janë konstatuar gjatë një kqyrje fizike në ambientet e “Gremi Clinic” që është kryer nga policia gjyqësore në datën 17 korrik 2025.

Gjithashtu, sipas dosjes hetimore po në vitin 2025, gjatë një raporti të Kontrollit Tatimor mbi këtë biznes, është konstatuar se shoqëria Juridike, “Gremi Wellnes” ka detyrime tatimore dhe gjopa të papaguara që shkojnë në shumën financiare prej 285 milion lekë të vjetra. Kjo kompani dhe pronarët e saj, bashkëjetuesit Dritan Gremi dhe Anduena Çela, prej Janarit 2021 kanë operuar si biznes me objekt tregtar fillimisht për “...aktivitete të këshillimit për biznes dhe këshilla të tjera për menaxhimin...”.

Por në muajin Nëntor 2025, objekti i kompanisë ndryshoi duke shtuar aktivitetin në fushën e menaxhimit të strukturave të ndryshme në fushën e shëndetësisë

“...kryesisht klinikave të kirurgjisë estetike dhe trajtimeve të tjera estetike, duke marrë përsipër menaxhimin në total të burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve me pacientët (caktimi i orareve të vizitave, të orareve të ekzaminimeve, të trajtimeve estetike dhe kirurgjikale, promovimet dhe ndjekja e politikave për zgjerimin e nr. të pacientëve etj....”-thuhet në objektin e veprimtarisë tregtare të ndryshuar në muajin Nëntor 2025.

Por vetëm pak ditë pasi Dritan Gremi, i ndryshoi objektin e veprimtarisë tregtare kompanisë “Gremi Wellnes”, ai në 27 Nëntor 2025, vendosi t’ia shesë 100 për qind të aksioneve të kësaj kompanie, bashkëjetueses së tij, Anduena Çela.

Kontrata e shitjes është firmosur para noteres Aida Hoxha në Tiranë dhe shitja është bërë kundrejt një çmimi prej 1 milion lekë të vjetra.

Por aktualisht në emër të Dritan Gremi, vijnë të jenë disa kompani të tjera si “Gremi Longevity Center”, “My Albania News”, “Gremi Sweet Bread”, “La Belle Noiseuse”, “Hotel Serenity”, “Gremi Clinic”, “Dritan Gremi”, “Viaggiare e Sorridere” e të tjera/elton qyno

Artikuj te sugjeruar

Plagosje me armë zjarri në Durrës

Një person është plagosur me armë zjarri në Durrës. Ngjarja ka ndodhur në lagjen nr. 1, në zonën e Vollgës, n...

AKTUALITET 16 Shtator17:43

Dosja Balluku dhe arredimi i vilës luksoze/ Pas më shumë se 1 orë, arkitekti Olsi Eftimi del nga SPAK

Olsi Eftimi ka lënë ambientet e Prokurorisë së Posaçme pas më shumë se 1 ore. Arkitekti i njohur mbërriti në am...

AKTUALITET 16 Shtator17:25

Çarje në tubacionin kryesor të Bogovës, ndërpritet furnizimi me ujë në Berat e Kuçovë

Që prej orës 13:00 është ndërprerë furnizimi me ujë të pijshëm në qytetet Berat dhe Kuçovë, si dhe...

AKTUALITET 16 Shtator16:00

Bashkëpunimi për vilat e fshehura/ Hetimet ndaj Ballukut, paraqiten në SPAK vëllezërit Alban dhe Olsi Eftimi

Hetimet e Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) për dosjen Balluku vijojnë, teksa rapor...

AKTUALITET 16 Shtator15:35

Taksistët protestë para Bashkisë së Tiranës: Të mos jepen licenca pa limit

Anëtarë të Sindikatës së Punonjësve të Transportit Taksi kanë protestuar këtë të mërkurë para b...

AKTUALITET 16 Shtator14:50

Bashkimi me Korçën ndez debatet në Maliq, banorët kundër hartës së re: Duam bashkinë tonë!

Banorët e Maliqit kanë kundërshtuar propozimin për shkrirjen e bashkisë së tyre dhe bashkimin me Bashkinë e Korçës...

AKTUALITET 16 Shtator14:41

Zbulohet një lokal i përshtatur për shitje droge dhe lojëra fati, arrestohet pronari

Policia ka zbuluar një lokal në rrugën "Thoma Koxhaj" në Tiranë, i cili dyshohej se përdorej për...

AKTUALITET 16 Shtator14:09

Parkimi me pagesë në Durrës, Këshilli Bashkiak diskuton kartën e rezidentit dhe tarifat

Në mbledhjen e sotme të Këshillit Bashkiak të Durrësit ndër të tjera u diskutua një çështje me interes për...

AKTUALITET 16 Shtator13:21

Pagat e magjistratëve, reagon Prokuroria e Përgjithshme kundër projektligjit: Krijon diferenca të pajustificuara

Prokuroria e Përgjithshme i ka përcjellë sot Kuvendit të Shqipërisë qëndrimin e saj zyrtar lidhur me projektligjin për...

AKTUALITET 16 Shtator13:20

Dënimi i ish-krerëve të UÇK, turma nga sheshet e Prishtinës niset drejt EULEX-it

Pas vendimit në Gjykatën Speciale, turma që gjendej në sheshet e Prishtinës është nisur drejt selisë së EULEX-it,...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 15 Shtator

Takimi pikant zgjat shumë dhe përfundon si mos ...

Një takim seksual tepër i gjatë, një vjedhje parash, një debat midis një eskorte dhe klientit të saj, dhe në fund një...

AKTUALITET 16 Shtator

Pagat ndryshojnë strukturë/ Gati gjysma e të pu...

Një e katërta e të punësuarve që derdhin kontributin e parë me pagë deri në 50 mijë lekë në muaj, ndë...

KOSOVA 16 Shtator

Dënohet me 25 vite burg Hashim Thaçi


Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është shpallur fajtor për krime lufte dhe është dënuar me 25 vjet burgim nga...

INVESTIGIME 31 Maj14:01


Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik


Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video




Çdo të premte | ? 20:45 | Syri TV





Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave





PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 16



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.